



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 115 prot

Kamëz, më 27.07.2022

V E N D I M

Nr. 98 Datë 27/07 2022

MBI

**“SHPRONËSIMIN NË INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT SHKOLLA “SULEJMAN ELEZI”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 27.07.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.86 Datë 26.07.2022 bazuar në shkronjën “dh” dhe “k” neni 54 ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik” të ndryshuar, VKM-së nr. 127, datë 23.03.2000 “Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik”, VKM-së nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik, VKM-së nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” si dhe Udhëzimi nr. 3, datë 28.12.2016 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016; **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e vlerësimit dhe përlllogaritjen e masës së shpërblimit të pasurive që do të shpronësohen për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit shkolla “Sulejman Elezi”;
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Kamëz;
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, do të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “truall”, në shumën 11,601,870 (njëmbëdhjetë million e gjashtëqind e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

4. Vlera e përgjithshme e kompensimit, (efektet financiare) prej 11,601,870 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë, do përballohen nga buxheti i vitit 2022 i Bashkisë Kamëz.
5. Kërkojmë Agjencisë Shtetërore të Shpronësimeve për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**KRYETAR KËSHILLI**

**Hysen KOLDASHI**

